



Bashkia Berat

---

**RELACION**

**PËR BUXHETIN VJETOR 2021 DHE**  
**PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM**  
**PËRFUNDIMTAR**  
**2021-2023.**



---

## **Përmbajtja e Plan Buxhetit 2021 dhe PBA Përfundimtare 2021-2023**

Mesazhi Kryetarit të Bashkisë Berat për buxhetin e vitit 2021

**Hyrje** .....

**1 .Vështrim i përgjithshëm** .....

1.1 Situata e njësisë së vetëqeverises vendore.....

1.2 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/vizioni/misioni/strategjia territoriale .....

1.3. Objektivat e P/buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2021.....

1.4 Informacion përmbledhës për P/ buxhetin e vitit 2021 dhe PBA 2021-2023...

**2. Parashikimet buxhetore afatmesme 2021 – 2023**.....

2.1 Plani financiar i periudhës afatmesme 2021-2023.....

2.2 Transferta e pakushtëzuar 2021.....

2.3. Transfertat sektoriale 2021.....

2.4. Transferta të kushtëzuara për funksione të deleguara.....

2.5 Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.....

2.6. Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2021 dhe PBA 2021-2023

2.7 Planifikimi i të ardhurat nga drejtoritë e bashkisë dhe institucionet e varësisë për vitin 2021 dhe PBA 2021-2023.....

**3. Parashikimi i shpenzimeve për periudhën 2021 -2023** .....

3.1 Stuktura Financiare e Buxhetit 2021.....

3.2 Detyrimet e prapambetura dhe plani i shlyerjes së tyre .....

3.3 Planifikimi shpenzimeve sipas ndarjes ekonomike.....

**3.3 A. Planifikimi i Shpenzimeve korrente**.....

A 1. Planifikimi i nr.të punonjesve.....

A 2. Planifikimi i shpenzimeve të personelit ( paga dhe sigurime shoqërore).....

A 3. Shpenzimet operative, të mirëmbajtjes dhe shërbimeve publike.....

A 4. Shpenzimet për pagesat e principalit dhe interesit nga huamarrja. ( kredia).....

A 5 . Shpenzimet për subvencione.....

A 6 Transferta tek organizatat dhe individë.....

A 7. Fondi rezerve, Fondi i kontigjencës, fondit i emergjencave civile.....

**3.2. B Planifikimi i shpenzimeve kapitale** ( fondi i investimeve ) .....

**4. Planifikimi i shpenzimeve njësisive shpenzuese dhe sipas programeve buxhetore**

**4.1** Bashkia Berat ( përfshi dhe Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi).....

**4.2** Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.....

**4.3** Ndërmarrja e Gjelberimit.....



Bashkia Berat

- 
4. 4. Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Shërbimit Veterinar.  
4. 5 Drejtoria Arsimore .....  
4. 6 Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”.....  
4. 7 Qendra “Lira”.....

**MESAZHI I KRYETARIT TË BASHKISË BERAT PËR BUXHETIN E  
VITIT 2021**

I nderuar z. Ervin CECA, Kryetarë i Këshillit të Bashkisë Berat!

Të nderuar këshilltarë!

Ne sjellim sot për miratim, Plan Buxhetin e vitit 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023, të hartuar me mbështetje korrekte ligjore e analizë ekonomike faktoriale përshtatur me kushtet e situatës pandemike dhe udhëzimeve të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë për këtë qëllim, në funksion të stabilitetit financiar në planin e vitit dhe atë trevjeçar, me moton :-

**Buxhet i Konsoliduar- Zhvillim i Qëndrueshem.**

Treguesit e paraqitur shprehin në korrektesë të plotë faktin ku jemi, ku duhet të jemi dhe balancimin e plotë të totalit buxhetor për çka synojmë të arrijmë. Kjo në të dy krahët – Të ardhurat dhe shpenzimet.

Ristrukturon në tërësi e tij, krahas shpenzimeve korente të vitit planifikues edhe detyrimet e prapambetura të mbatura, me objektivin për të përmbushur objektivin e parashtruar në PBA e më parshme për të shkuar në vitin 2023 në variantin më optimal likuidimin e tyre të plotë në vitin 2023. Objektiv ky jo vetëm kurajoz por i mbështetur në atë çka kemi realizuar e mirëprogramuar.

**Objektivat buxhetore 2021-2023, qartësisht të fokusuar në :**

- Shpenzime të shtuara për të përballuar në maksimumin e mundshëm situatën pandemike, nëpërmjet shtimit të shërbimeve për dizinfektim, pastrim dhe mbështetje sociale.
- Shërbime të shtuara publike në një sipërfaqe më të madhe territoriale, por dhe cilësisht më të mira.
- Përmirësim të dukshëm të shërbimeve në arsim dhe intitucionet e kopështeve dhe çerdheve. Theksojmë këtu rimarrjen nga Bashkia të funizimit me ushqime për çerdhe dhe kopështet publike duke mos vijuar me marrjen e këtij shërbimi nga të tretët. Paisjen e këtyre institucioneve edhe me elementë të tjerë të domosdoshëm per ngrohje e higjenë.



## Bashkia Berat

---

- Stabilitet financiar të bashkisë në periudhën afat shkurtër dhe atë afatgjatë, si një parim bazë i qeverisjes në mandatin tonë 4 vjeçar, me objektivin themelor rritjen e aftësisë financiare për shërbime të shtuara dhe rritjen e aftësisë për t'u përfshirë në projekte financuese për investime të reja në gjithë hapësirën urbane të bashkisë.

Ky buxhet, mbëshetet në paketën fiskale të vitit 2020, dhe analizën financiare faktoriale të zhvilluar në një periudhë tremujore shtator – nëntor 2020. Pasqyron në mundësinë më të mirë të mundshme mendimin e komunitetit dhe grupeve të interesit, tërhequr në kushtete e reja me të gjithë format e mundshme si dhe dëgjuesat e organizuara nëpërmjet postës elektronike dhe atyre online. Zhvilluar këto përshtatur me situatën e krijuar.

Edhe ky plan buxhet nuk i largohet sërish detyrimit për të likuiduar ende detyrimet e trashëguara për faturat e prapambetura nga ish bashkia që trashëguam, por ndihemi realistw dhe pozitivw që pavarësisht situatës ne kemi shlyer shumën e planifikuar për vendimet gjyqësore për vitin 2020, kemi likuiduar fatura të shërbimeve të vitit 2019 dhe ndonjë jo në vlerën absolute të parashikuar, kemi likuiduar edhe fatura të prapambetura të investimeve nga vitet e mëparshme.

Por ne jemi shpresë plotë kur krahasojmë veten me vitin e parë të administrimit dhe manaxhimit të bashkisë për sasinë e investimeve që janë sjellë gjatë vitit që po lëmë pas dhe të tjera investime për të cilat janë siguruar fondet e financimit të tyre që do fillojnë gjatë vitit 2021.

Por jo vetëm!

Bashkia është pjesë e këtyre investimeve pasi jo vetëm në vitin 2020, planifikoi dhe likuidoi kostot të shpronësimeve, si pjesë e investimit total, por dhe në planin që sjellim për miratim, planifikon të likujdojë shpronësime si pjesë e investimeve që kanë filluar ose do të fillojnë në rreth 4% të total buxhetit të saj.

Për emergjencat civile planifikon rreth 5 % të buxhetit të saj duke përmbushur detyrimin ligjor për këtë qëllim.

Plan buxheti i vitit që sjellim për miratim, vijon përmirësimin e situatës financiare të Bashkisë, shprehur kjo në balancën buxhetore midis PBA së mëparshme dhe PBA 2021-2023, duke i shtuar kësaj të fundit investime të reja gjatë vitit buxhetor 2021.

Parë në kontekstin e vijueshmërisë pozitive ku po ecin financat e Bashkisë, ka në përmbajtjen e tij ato drejtime kryesore që kishte dhe buxheti i vitit 2020 dhe shton vëmendjen ndaj rinisë.



## Bashkia Berat

---

Kjo jo vetëm në fushën organizative dhe manaxheriale por edhe me fonde buxhetore të shprehura në vlerë.

Vlen të citojmë se edhe investimet e huaja me donatorë dhe kontributin financiar të bashkisë, krahasimisht me vitin e parë kemi një gamë jo pak të rëndësishme, referuar jo vetëm numrit të projekteve që janë në implementim por dhe vlerës së tyre. Vetëm për këto projete bashkia planifikon rreth 29.8 milion lekë si kontribut të saj.

Me bindjen se ky plan buxhet materializon në përmbajtjen e vetë plotësisht objektivin tonë për **Buxhet të Konsoliduar- Zhvillim i Qëndrueshëm** shpreh bindjen se do të marrë miratimin tuaj për të vijuar konsolidimin ekonomik të Bashkisë sonë.

**Ju faleminderit!**

**Ervin DEMO**

**KRYETAR I BASHKISË BERAT**



## **HYRJE**

Bashkia harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, të pavarur, të cilin e harton në mënyrën e parashikuar me ligj, pa defiçit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon administrimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin për financat vendore nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 7 datë 27.02.2019 “ Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2020-2022 ”, ligjin nr. 139/ 2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 41 “Buxheti i Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore dhe Program Buxhetor Afatmesëm”.

Programi buxhetor afatmesëm 2021-2023, të cilin sjellim për miratim ka si objektiv të tij, krijimin e premisave për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social dhe territorial të bashkisë nëpërmjet ofrimit cilësor të shërbimeve dhe shtrirjen e tyre në gjithë hapësirën territoriale të bashkisë.

Bazë e rëndësishme në procesin e përgatitjes së buxhetit janë të gjithë dokumentat Strategjike, ato të miratuara dhe ato në proces sikurse është SZHEL e cila ndodhet në fazën e konsultimit publik me gjithë grupet e interesit për një shtrirje kohore deri në vitin 2030, të cilat konturojnë objektivat e zhvillimit ekonomik dhe prioritetet kryesore, pjesë e zhvillimit afatmesëm të ekonomisë lokale.

Në tërësinë e tij buxheti vjetor 2021 dhe buxheti afatmesëm 2021-2023 është :

- ✓ Dokumenti që përmbledh tërësinë e të ardhurave, financimeve dhe shpenzimeve, i miratuar nga Këshilli Bashkiak .
- ✓ Instrumenti më i rëndësishëm në menaxhimin e financave publike, për qeverisjen lokale.
- ✓ Mjet komunikimi ndërmjet qytetarëve (komunitetit) dhe të zgjedhurve vendorë
- ✓ Dokumenti që lidh politikat e prioritetet nën kushtin e burimeve financiare të kufizuara për shpenzimet publike.
- ✓ Produkt i një bashkëpunimi të strukturave të brendshme, që lidhet me përgjegjësitë ligjore të administratës së Bashkisë dhe Njësisve Administrative, ndërmarrjeve dhe institucioneve në varësi të saj, quajtur dhe njësi shpenzuese.



## Bashkia Berat

---

Ai shpreh mënyrën e sigurimit të burimit të të ardhurave dhe përdorimin e tyre, si dhe mat e përcakton indikatorët prioritar në funksion të përmbushjes së qëllimit kryesor dhe objektivave të matshme dhe të arritshme në kohë. Por ai vjen nga një proces i gjatë konsultimi dhe një analize të plotë SWOT.

Duke u strukturuar si një dokument i rëndësishëm, i thjeshtë dhe qartësisht i kuptueshëm, ai bëhet lehtësisht i përdorshëm jo vetëm nga Këshilli Bashkiak por dhe nga çdo përdorues i jashtëm. Siguruar kjo nëpërmjet tregëve analitik, të matshëm dhe të krahasueshëm në një periudhë kohe afatmesëm dhe treguesve agregat ë materializuar në treguesit sipas programeve. Bazë e rëndësishme në hartimin e tij është kosto produkt në vetë strukturën e shpenzimeve dhe të ardhura transparente sipas burimit të gjenerimit të tyre.

### ***1.1 Situata e njësisë së vetëqeverises vendore***

E shtrirë në Krahinën Malore të Shqipërisë Jugore dhe pjesërisht në Ultësirën Perëndimore në të dy anët e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të lumit Osum, Bashkia Berat është një atraksion jo vetë turistik por dhe një njësi ekonomike me resurse të medha zhvillimi.

Ajo përfshin brënda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Beratit, njësitë: Otlak, Velabisht, Roshnik, dhe Sinjë. Ose në total nga 7 njësi administrative.

Tregues të rëndësishëm statistikor bazë të saj janë:

Sipërfaqja: Bashkia Berat ka një sipërfaqe totale 380 km<sup>2</sup> e cila klasifikohet në tokë bujqësore prej 170 km<sup>2</sup>, (përfshirë këtu tokat e kultivuara dhe jo të kultivuara) dhe tokë natyrore 180 km<sup>2</sup> (përfshirë këtu pyjet dhe kullotat)

Karakteristika të veçanta kanë njësitë përbërëse të bashkisë pjesë e ish komunave si :- Njësitë Otlak dhe Velabisht të cilat në sipërfaqen e tyre kanë më shumë tokë bujqësore, dhe njësitë Roshnik e Sinjë që kanë në strukturën e sipërfaqes së tyre teritoriale tokë bujqësore të fragmentarizuar me sipërfaqe më të madhe të tokës natyrore, dhe relief kodrinor malor.

E përshkruar nga nga lumi i Osumit Bashkia Berat është me ujëra nëntokësor e burime ujore sipërfaqësore.

Sipërfaqja totale ujore është 9 km<sup>2</sup>.

Sipërfaqet banuara janë 4.63 km<sup>2</sup>.

Industria dhe ekonomia shtrihen në një sipërfaqe prej 1.34 km<sup>2</sup>.

Bashkia përshkohet nga 812 km rrugë.



## Bashkia Berat

Qyteti i Beratit gjendet 58 m. mbi nivelin e detit dhe ka një sip. 22.4 km<sup>2</sup> nga e cila 6.3 km<sup>2</sup> janë sipërfaqe urbane.

Ai pozicionohet:

- 125 km larg kryeqytetit të Shqipërisë dhe aeroportit Nënë Tereza
- 92 km nga porti i Durrësit
- 85 km nga porti i Vlorës
- 212 km nga porti i Sarandës
- 250 km nga pikat kufitare të Kakavijës dhe kapshticës.

**Tabela 1. Ndarja administrative e Bashkisë Berat**

Njësitë admin. përbërëse	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Fshatrat/Qytetet në përbërje të tyre
Berat	19 km <sup>2</sup>	Qyteti Berat
Otllak	52.7 km <sup>2</sup>	Lapardha1, Lapardha2, Qereshnik, Balibardhë, Dyshnik, Moravë, Ullinjas, Vodëz e sipërme, Orizaj, Otllak.
Velabisht	93.2 km <sup>2</sup>	Malinat, Bilçë, Drobonik, Bardhaj i Ri, Starovë, Veterrik, Remanicë, Gjoroven, Palikësht, Veleshnjë, Duhanas, Kodras, Velabisht.
Sinjë	138.5 km <sup>2</sup>	Mbolan, Mjeshovë, Mbreshtan, Galinë, Sadovicë, Paftal, Kamçisht, Levan, Velçan, Osmenezet 1, Osmenezet 2, Plashnik i Vogël, Molisht, Sinjë.
Roshnik	78.7 km <sup>2</sup>	Bogdan i Poshtëm, Bogdan i Sipërm, Dardhë, Karkanjoz, Kostren i Madh, Kostren i Vogël, Mimias, Perisnak, Qafë Dardhë, Vojnik, Rabjak, Roshnik Qendër, Roshnik i Vogël.

Berati është qendër ndërkombëtare e trashëgimisë kulturore (lagjet tradicionale të Mangalemit, Goricës dhe Kalasë, Muzeu Kombëtar i Ikonografisë “Onufri” dhe galeritë tjera, muze, kishat, xhamitë).

Historia mbi 2400 vjeçare e bën atë ndër qytetet më të vjetër të vendit tonë. “Qytet Muze” nga viti 1961 dhe aktualisht pjesë e listës të UNESCO-s si një qytet i Trashëgimisë Kulturore Botërore. Në skajin lindor të territorit të saj, bashkia ka një pjesë të Parkut Kombëtar të Tomorrit (2,416m), ndërsa në perëndim përfshin Malin e Shpiragut (1,218 m).

Sektorët kryesorë mbi të cilët mbështetet ekonomia e Bashkisë Berat janë bujqësia, turizmi, agro përpunimi dhe sektori i shërbimeve.





## Bashkia Berat

---

Njësitë Otlak, Roshnik, Velabisht dhe Sinjë kanë si sektor bazë bujqësinë. Kultivimi i pemëve frutore, ullinjve dhe vreshtarisë është parësor në këto zona.

Në Berat prodhimi i ullirit është në nivele të larta dhe është një nga produktet bujqesore të rëndësishme ku sipërfaqja e mbjellë me ullinj është 31.9 km<sup>2</sup>.

Berati është zhvilluar si qëndër rajonale për agrobiznesin, tregtinë dhe turizmin. Kjo si rrjedhojë e pozicionit gjeografik, traditës historike, resurseve që mbart në këtë fushë dhe aksesit me rrugët kombëtare.

E rëndësishme të citojmë si tregues mesatar se Qyteti i Beratit ka si sektor kryesor ekonomik shërbimet, **66.9%** është raporti i numrit të punësuarve në këtë sektor ndaj numrit të punësuarve gjithsej. Duke u pasuar nga industria me **29%** dhe në fund bujqësia me **4.1 %**.

Njësitë Otlak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik kanë si sektor kryesor të ekonomisë bujqësinë. Në njësinë Sinjë dhe Roshnik punësimi në bujqësi me rreth vlerën **90%**.

Krahasimisht për pozicionimin e vëndodhjes së biznesit treguesit statistikor janë :

Biznesi i madh përbën 22 % të totalit të numrit të bizneseve, biznesi i vogël përbën 75 % dhe ai ambulant dhe institucionet 3% të tij.

Numri total i bizneseve është **2325**, prej të cilave biznesi i madh **502** dhe biznesi i vogël **1745** biznese, dhe kanë këtë shpërndarje të tyre

Qyteti Berat nga totali prej **2325** biznese ka **1,792** biznese ose **77 %** të numrit total. Nga të cilat 80% të biznesit të madh ( **402** biznese në numër) dhe **75 %** të biznesit të vogël (1311 biznese në numër)

Njësia Otlak ka **306** biznese në total ose **13.1 %** të totali, prej të cilave **68** biznese të mëdha dhe **238** biznese të vogla që shprehur në përqindje ndaj totalit të bashkisë janë biznesi i madh **13.5 %** dhe **13.6 %** biznesi i vogël.

Njësia Velabisht ka **7%** të numrit total ose **155** biznese nga të cilat **3%** të totalit të biznesit të madh ose **13** biznese dhe **8 %** të totalit të biznesit të vogël ose **132** biznese.

Njësia Roshnik ka **1%** të numrit total të bizneseve ose **31** biznese nga të cilat **1%** të totalit të biznesit të madh ose **3** biznese dhe **2 %** të totalit të biznesit të vogël ose **28** biznese.

Njësia Sinjë ka **2%** të numrit total të bizneseve ose **41** biznese nga të cilat **3%** të totalit të biznesit të madh ose **15** biznese dhe **1 %** të totalit të biznesit të vogël ose **26** biznese.

Njohur si në potencial jo më pak ndikim në të ardhurat vëndore Bashkia është përfshirë në një punë të plotë projektuese për tregjet me qëllim që të stabilizohen dhe të krijohen kushtet për



## Bashkia Berat

zhvillim normal të aktivitetit të tyre sidomas për sa ju përket tregjeve sezonal të produkteve bujqësore.

Treguesit demografikë kanë rëndësinë e tyre ndaj dhe viti 2020 tregoi stabilitet në këtë drejtim duke ruajtur një numër popullsie mbi **100** mijë banorë.

Analizuar gjëndjen financiare të bashkisë, e rëndësishme të theksojme se Bashkia Berat, nuk është Bashki në krizë, dhe viti financiar që mbylлим ja përmison gjëndjen financiare të saj, por nuk e nxjerr atë ende nga situata e vështirë financiare.

Ka harmonizuar implementimin e projekteve, ka ekonomizuar fondet pa cënuar shërbimet përkundrazi i ka shtuar, përmirësuar ato dhe ka bërë të mundur të shtohet numri i përfituesve të komunitetit për shërbime që kurrë nuk ishin bërë më parë.

Ka përballuar në maksimumin e saj më të mundshëm situatën e krijuar, dhe ecën e sigurt në objektivat e programuara qoftë në objektivat afatshkurtër apo dhe në afatgjatë.

### **1.2 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/ strategjia territoriale . Orientimi afatgjatë i bashkisë ( drejtimet kryesore të saj. Burimi i informacionit: PPV/PZhS)**

**Vizioni strategjik**, që do të udhëheqë zhvillimin e Bashkisë së Beratit gjatë 15 viteve të ardhshme” *“Berati është një qytet i trashëgimisë kulturore botërore, me një strukturë të unifikuar e të konsoliduar, urbane dhe rurale, me cilësi të lartë jetese, i lidhur mirë me zonat qendrore të Shqipërisë përmes një infrastrukturë moderne, si një destination i fuqishëm turistik dhe portë hyrese/pritëse për një rajon të pasur natyror.*

*Një nga asetet me me vlerë të Bashkisë Berat janë qytetarët e saj, ndaj rëndësi e veçantë i jepet nxitjes së kualifikimit të kapitalit njerëzor, për të rritur integrimin e të gjithë qytetarëve aktive në tregun e punës.*

**Qëllimi kryesor:** *harmonizimi i zhvillimit ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual të shoqërisë përmes parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.*

*Misioni i bashkisë në funksion të këtij vizioni zhvillimi është:*

*Vënia në dispozicion në menyrë inteligjente e të gjitha burimeve financiare e njerëzore për harmonizimin e interesave publike dhe private, për zhvillim ekonomik e social në të gjithë territorin e Bashkisë Berat.*



## Bashkia Berat

---

**Strategjia e zhvillimit të qytetit të Beratit** është e përbërë nga gjashtë objektiva strategjike .

**Objektivi Strategjik 1:** Orientimi i zhvillimit hapsinor me instrumenta inovativ të tokës me qëllim strukturimin e hapsirës urbane në funksion të nxitjes dhe fuqizimit të një ekonomie të larmishme në sektor dhe mjedis cilësor për komunitetin.

**Objektivi Strategjik 2:**

Zhvillimi i turizmit shumë dimensional historiko-kulturor dhe eko/agrar në një mjedis të shëndetshëm, të qëndrueshëm e me vlera natyrore, si sektori bazë në zhvillimin ekonomik lokal dhe rritjen e mirëqënies sociale të komunitetit.

**Objektivi Strategjik 3:**

Fuqizimi i aksesit brenda territorit të bashkisë si dhe bashkisë dhe nderlidhjes mes vëndbanimeve e me kufitare e rajonit.

**Objektivi Strategjik 4:**

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë në funksion të zhvillimit rural dhe uljes së papunësisë.

**Objektivi Strategjik 5:**

Përmirësimi i infrastrukturës të sistemit arsimor dhe shëndetësor si dhe zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse të zbutjes së pabarazisë sociale dhe ngritjes së qendrës Rinore.

**Objektivi Strategjik 6 :**

Mbështetje e biznesit për të diversifikuar aktivitetin e tij dhe nxitja e sipërmarresve të rinj me synim krijimin e një ekonomie lokale të qëndrueshme dhe konkurruese në rajon.

Në programin buxhetor afatmesëm 2021-2023 do të gjejnë mbështetje financiare prioritetet e kërkesave të komunitetit të cilat janë përfshira në planet sektoriale të Bashkisë Berat trajtuar në pjesët përbërëse të këtij materiali.

Burimi i informacionit: PPV/PZhS

### **1.3 OBJEKTIVAT E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2021**

Programi buxhetor **2021-2023**, është një dokument planifikimi afatmesëm mbështetur në planin strategjik të zhvillimit (atij në fuqi dhe draftit të ri në studim), për të bërë të mundur realizimin e tij si dhe garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm, me objektiv primar:



## Bashkia Berat

---

### **përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj komunitetit, dhe stabilitet ekonomik e financiar të Bashkisë Berat.**

Përgatitja e buxhetit vjetor 2021 si pjesë përbërëse e procesit të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023, ku buxheti vjetor është viti i dytë i programit katër vjeçar të mandatit tonë qeverisës.

Në plotësim të misionit: -**“Buxhet i balancuar, Zhvillim i Qendrushëm”** kemi planifikuar fondet e nevojshme me prioritet tre shtylla kryesore, duke ruajtur boshtin e programit katër vjeçar qeverisës dhe në përshtatje të plotë me dokumentat startegjik që sipër cituam:

- a) **Shërbime Publike** cilësore dhe të shtuara nga ana sasiore.
- b) **Vëmendje të plotë për Arsimin** e për përmirësimin e infrastrukturës, *për një Berat - qytet të fëmijëve.*
- c) **Zhvillim Kulturor** me impakt të rëndësishëm social.
- d) **Rritje të vëmendjes ndaj rinisë** shoqëruar kjo me investime të shtuara për këtë qëllim.

**Objektivi i përgjithshëm i buxhetit 2021:** Menaxhimi korrekt i financave vendore, sigurimi i përdorimit të fondeve publike në respektim të parimeve të ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit, **në funksion të realizimit të misionit të Bashkisë**, dhe në zbatim të VKB, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe PBA Përfundimtare 2021-2023”, por jo vetëm.

*Ndër objektivat e rëndësishëm të tij citojme:*

**1. Realizimi i planit të të ardhurave vendore, të planifikuara, përshtatur me situatën pandemike.**

*Në Shërbimet publike vendore:*

**2. Mirëmbajtjen e të gjithë hapësirave urabne në të gjithë territorin e bashkisë si dhe mirëmbajtjen e rrugëve rurale në inventarin e bashkisë, shtimi me 3,000 m<sup>2</sup> segmente rrugore me kalldrëm:**

- ✓ Rruga Kodra e sulmit .....1000 m<sup>2</sup>
- ✓ Rruga Lisi i Becit .....500 m<sup>2</sup>
- ✓ Rruga Vangjel Zoto.....1000 m<sup>2</sup>
- ✓ Rruga Agron Elezi.....500 m<sup>2</sup>

**Sheshe me pllakë trotuari 600 m<sup>2</sup>,**

- ✓ Sheshi pranë ish martenitetit rruga Antipatrea..... .....250 m<sup>2</sup>



## Bashkia Berat

- 
- ✓ Sheshi Bulevardi Rrepublika .....250 m<sup>2</sup>
  - ✓ Në rrugën Antipatrea .....100 m<sup>2</sup>

### **Mirëmbajtje rrugësh (riparim) me asfalt 1000 m<sup>2</sup>**

- ✓ Rruga Qypëllinjte' Rajoni N3 .....100 m<sup>2</sup>
- ✓ Rruga Çerçis Zyberi Rajoni N2 .....350 m<sup>2</sup>
- ✓ Mbushje riparime në segmentet rrugore të dëmtuara të Beratit dhe rrugëve të brëndshe të llagjeve .....150 m<sup>2</sup>
- ✓ Qendra në Dyshnik Njësia Administrative Otlak ..... 200 m<sup>2</sup>
- ✓ Rruga e brëndshme në Fshatin Mbreshtan Njësia Administrative Otlak ....100 m<sup>2</sup>
- ✓ Rrugë të brëndshme Fshati Lapardha Njësia administrative Otlak .....100 m<sup>2</sup>

### **Mirëmbajtje të urave :**

- ✓ Ura e Goricës me gurë
- ✓ Ura e Varur ( konstruktion me kavo celiku )
- ✓ Ura e Re ( konstruktion beton arme me parmak druri )
- ✓ Ura e Varur e Gjorovenit me dërrasa
- ✓ Ura e Varur e Lapardhase me dërrasa

### **3. Mirëmbajtja e sistemit të kanalizimeve të ujrave të bardha, të larta dhe i pusetave**

#### **Në Njesinë Administrative Nr. 1 , Nr. 2 , Nr. 3 , Velabisht , Sinjë , Otlak , Roshnik.**

- Mirëmbajtja dhe pastrimi i kanalizimeve të ujrave të bardha në **830** zgara të vogla ekzistuese në Njësitë Administrative. Nr. 1 , Nr. 2 , Nr. 3.
- Mirëmbajtja dhe pastrimi kanalizimeve të ujrave të larta me **30** zgara pritëse të mëdha në të gjithë territorin e bashkisë
- Pastrimi i përrenjve të mëposhtëm :
  - Përroi i Kananit
  - Përroi i Lisit i të Becit
  - Përroi i Suelasit
  - Përroi Pusi me Canit
  - Përroi i MCR
  - Përroi në lagjen “ 1 Maji’



## Bashkia Berat

- Sistemimi i përroit të Avramit në lagjen “13 Shtatori”
- Sistemimi i ujrave të bardha në lagjen Kala. Do vendosen Puseta KUL 10 copë

### 4. Mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore.

- ✓ Përfshihet mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale në rrugët e qytetit dhe fshatrave, duke kryer të gjitha proceset e punës për mirëmbajtjen, aplikimin e vizatimeve trafikndarës dhe të këmbësorëve, për mirëmbajtjen e sinjalistikës vertikale, tabelave rrugore etj.
- ✓ Vijëzimi i vijave të bardha të këmbësorëve me përmasa 3 x 0.5 m, në total 1450 m<sup>2</sup> në rrugët :
- ✓ Vijëzimi i vijave gjatësore trafik ndarëse me gjërësi 12 cm, në total 23400 ml në rrugët :

### 5. Ndërtime mure mbajtës në Bashkinë e Beratit për vitin 2021

- ✓ Lagja Barrikadë Rajoni Nr.1.....60 m<sup>3</sup>
- ✓ Lagja Donika Kastrioti Rruga Lisi i Becit Rajoni Nr3, ..120 m<sup>3</sup>
- ✓ Rruga Haxhi CENO Lagja Barrikadë .....50 m<sup>3</sup>
- ✓ Rruga Uzurgulinjte lagja 28 Nëntori do ndërtohen .....42 m<sup>3</sup>
- ✓ Ndërtim muri në Fshatin Levan ndërtim muri mbajtës të Rrugës 84 m<sup>3</sup>
- ✓ Totali ndërtim mure .....356 m<sup>3</sup>.

### 6. Ndërtime Segmente rrugësh me beton në pjesë të vështira në Bashkinë e Beratit për vitin 2021 gjithsej 2170.

- Njësia Administrative Otlak beton .....340 m<sup>2</sup>
- Rruga Kostandin Berati Rajoni N3 .....1000 m<sup>2</sup>
- Rruga Kamcisht 130ml ose .....460 m<sup>2</sup>
- Uznovë .....370 m<sup>2</sup>

### 7. Mirëmbajtja e rrugëve rurale të asfaltuara

Inventari i rrugëve sipas VKM nr 915 dt 11.11.2015.

- Rruga K/ Dyshniku – Roshnik ..... 1.1 km
- Rruga Duhanas – Roshnik ..... 8 km
- Rruga K/Velabishtit – Starovë ..... 1.5 km
- Rruga K/Gjrovenit – Gjroven..... 4 km



## Bashkia Berat

---

- Rruga K/Duhasanit – Duhasan..... 4 km
- Rruga K/Bilç – Malinat.....18 km
- Rruga Urë Vajgurore – Veterik ..... 3 km
- Rruga K/ Lapardhase – Lumas.....12 km
- Rruga Berat – Sinjë.....22 km

8. **Rritjen e hapësirave të gjelbërta** nëpërmjet shtimit të sipërfaqeve të reja, në lagjet e Beratit. Kjo duke rritur edhe më shumë e cilësishtë më mirë shërbimet e nevojshme dhe të domosdodhme në parqet ekzistuese. Krahas shtimit të sipërfaqeve me lule sezonale dhe mbjelljes së pemëve të reja. Shoqërimin e projekteve të reja me mbjellje dhe mirëmbajtje të sipërfaqeve të gjelbëra.

9. **Për vitin 2021**, programojmë të mbjellim 292 pemë të reja dhe të mbjellim me lule sezonale **4821 m<sup>2</sup>**.

10. **Përmirësimin e infrastrukturës arsimore**, edhe në këtë buxhet e përcaktojmë si një objektiv të rëndësishëm dhe kjo mbështetur në kërkesat që kanë këto objekte.

11. **Në aspektin social:**

12. Përfshirja në skemën e **përfitimit të subvencionim të qirasë** në tregun e lirë me **probleme sociale dhe ekonomike**, konkretisht familjet që kanë persona me aftësi të kufizuar në përbërjen familjare, gratë e divorcuara me fëmijë në ngarkim dhe familjet me të ardhura familjare mujore shumë të ulëta.

13. Bashkia Berat edhe në vitin 2021 **do të mbulojë interesat e kredisë për familje të pastreha**, pjesë e programit që u implementua gjatë vitit 2020.

14. **Përfshirja nga tarifa mujore e pagesës ushqimore në kopështe/çerdhe** të fëmijëve prej: komunitetit rom/egjyptian, fëmijë të familjarëve përfitues të ndihmës ekonomike, të nënave kryefamiljare, fëmijë me aftësi ndryshe dhe të diagnostikuar me sëmundje terminale, të vërtetuar nga KMCAAP.

**Shërbimet publike të kontraktuara:**

15. **Qytet i pastër dhe ky në saj të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane efektiv dhe eficient**, për të gjithë zonën ku ka akses kontrata e sipërmarrjes së këtij shërbimi, nëpërmjet një sistemi më efikas të matjes dhe monitorimit të tij. Përfshirë këtu dhe mirëmbajtjen e hapësirave urbane që nuk janë pjesë e kontratës, mirëmbajtje kjo që kryet nga Bashkia me punonjësit e vetë të shërbimeve.



- 
16. **Rritje e performancës së ofrimit të shërbimit të mirembajtjes së varrezave publike** dhe të dëshmorëve, nëpërmjet një sistemi më efikas të matjes dhe monitorimit, ofrimit të shërbimit të standartizuar për varrezat publike.
17. Vlerësimi i nevojave për zgjerim territori për varreza.  
*Në aspektin kulturor dhe sportive.*
18. **Gjallërimin e jetës social – kulturore dhe artistike nëpërmjet mbështetjes financiare të aktiviteteve sociale, kulturore dhe sportive në qytet në bashkëpunim edhe me donator dhe partner vëndas dhe të huaj.**
19. **Harmonizimin dhe përfshirje të kërkesave të komunitetit të dala nga dëgjesat publike me planet sektoriale të bashkisë dhe të ndërmarrjeve e institucioneve në vartësi të saj, mbështetur në kapacitetin financiar të Bashkisë.**  
*Në sektorin e bujqësisë dhe ujitjes.*
20. **Mirëmbajtje dhe pastrim i rrjetit të ujitjes dhe kullimit** duke siguruar rritjen e cilesisë së shërbimit për fermerë të lidhur.
21. Rehabilitimi dhe rikonstruksioni i **infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit** dhe veprave të mbrojtjes nga përmytja në zonat e banuara.
22. Mbrojtja dhe **rritja e sipërfaqeve pyjore/ kullosore/ shërbimi pyjor** sipas mënyrës së përcaktuar në ligj.
23. Ndërtimin e rrugëve midis parcelave bujqësore në partneritet me komunitetin e zonave përkatëse.
24. **Likujdimin brënda vitit 2021 shumën 119,061,000 lekë ose duke përdorur 12% të totalit të shpenzimeve të bashkisë për vitin 2021, shumë kjo që amortizon pjesë të konsiderueshme të totalit të borxhit progresiv, të përbërë nga fatura të administruara nga bashkia dhe ndërmarrjet e vartësisë. Pjesa tjetër projektohet të likujdohet në buxhetin e vitit 2022 dhe në vitin 2023 objektivi ynë detyrim të prapambetura në progresiv të jetë zero, përjashto këtu investimet afatgjata të shtrira në kohë.**

**Fokusi i punës sonë gjatë vitit 2021 do të synojë:**

1. **Implementim korrekt të planit të të ardhurave**, në plotësim të rregullave dhe parimeve të sanksionuara me ligj në hartimin, konsultimin, miratimin, e gërshetuar kjo me një menaxhim të shëndoshë financiar.





- 
2. **Motivimin dhe angazhimin maksimal të administratës së bashkise për plotësim të planit e të ardhurave**, duke e planifikuar e administruar ato atje ku dhe lindin sipas drejtorive përkatëse dhe funksionit të tyre.
  3. **Maksimalizimin lufës kundër evazionit fiskal gërshetuar kjo me rritjen e partneritetit biznes - pushtet vendor** për krijuar premisa për konkurrueshmëri gjithnjë e më reale, midis biznesit dhe një qëndrueshmëri të mbledhjes së të ardhurave të planifikuara.
  4. **Planifikimi korrekt dhe profesional do të shoqërohet me masa konkrete të mirëprogramuara për të siguruar efektivitet maksimal të të gjitha të ardhurave me vëmendje të shtuar ndaj pronave bashkiake**, dhe arkëtimin e detyrimeve që ka biznesi ndaj Bashkisë.
  5. **Ritjen e efektivitetit ekonomik të kostos së shërbimeve publike** me sipërmarrje dhe mbulimin e shërbimeve të shtuara me kapacitetet e vetë Bashkisë.
  6. **Rritja e gadishmërise nëpërmjet marrjes së masave paraprake organizative, manaxheriale e materiale** për përballimin e emergjencave civile, të shtuara edhe në kuadrin e përballimit të situatës pandemike.
  7. **Përgjigjen e menjëhershme për dhënien e ndihmës në raste fatkeqësish** sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
  8. **Gjetja e hapësirave të mundshme me objektiv uljen e numrit të familjeve të pastreha** nëpërmjet implementimit të projekteve dhe marrveshjeve me partnerë të biznesit privat sikurse janë bankat e nivelit të dytë për mundësinë e implementimit të projektit për kreditë e buta.
  9. **Përditësim korrekt të të dhënave për familjet me probleme sociale dhe ekonomike** me vëmendje të shtuar - familjet që kanë me persona me aftësi të kufizuar në përbërjen familjare, gratë e divorcuara me fëmijë në ngarkim dhe familjet me të ardhura familjare mujore shumë të ulëta, **për të përfituar nga skemat për strehim social dhe gjithë lehtësirat fiskale që i ofron paketa fiskale.**
  10. **Të forcojë dy mekanizma shërbimesh: Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Dhunës me Bazë gjinore**, duke synuar mbrojtje të vecantë të të drejtave të fëmijëve nëpërmjet marrjes së masave për t'i siguruar ushtrimin e të drejtave të tyre brënda kuadrin ligjor, bashkëpunimit midis strukturave dhe autoriteteve qendrore e lokale.



11. **Përmirësimin e shërbimit të transportit** duke synuar një përfaqje të integruar në zhvillimin dhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve, në mbrojtje të ambientit, një transporti i qëndrueshëm, i besueshëm dhe me mjete që duhet të përmiresohen duke ju përafruar standarteve të Komunitetit Europian.
12. Shfrytëzimin në mënyrë të **qëndrueshme të fondit pyjor** dhe kullotor dhe mirë administrimin e tyre, për të krijuar mbështetje reale për këtë sektor të rëndësishëm ekonomik.
13. Monitorim, kontroll dhe kujdes të shtuar **për inspektimin e produkteve blegtorale**, kryesisht produktet e mishit, si dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për tregtimin e produkteve nëpërmjet mirëadministrim të tregjeve ku ofrohen këto produkte.

#### **1.4 INFORMACION PËRMBLEDHËS PËR PËRGATITJEN E BUXHETIT TË VITIT 2021 DHE PBA 2021 - 2023.**

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr 23 date 30.07.2018, ‘Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të qeverisjes vendore’, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 7 datë 27.02.2019 ‘Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022’, u ngrit Grupi për Menaxhim Strategjik me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë si dhe Ekipet e Menaxhimit të Programit, u përgatit Udhëzimi për përgatitjen e PBA 2021-2023 dhe u vu në dispozicion të Grupit për Menaxhim Sstrategjik dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programit.

Në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 36, si dhe të Kalendarit Buxhetor për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, Bashkia Berat përgatiti fazën e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023. U miratua me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 51 datë 15/09/2020 “Vlerësimet afatmesme 2021-2023 të të ardhurave” si dhe “Tavanet përgatitore të PBA 2021-2023” .

Bashkia Berat ka depozituar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë projekt-dokumentit e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm, me shkresën nr.4329 prot. datë 15.09.2020.

*Plani i veprimit, proces verbalët e dëgjësive publike si dhe lista e pjesëmarrësve janë pjesë e dokumentave të përgatitjes dhe miratimit të PBA 2021-2023.*

*Theksojmë se në këtë plan buxhet, sikurse dhe ligjërisht është e përcaktuar, administrata dhe këshilltarët e këshillit bashkiak, i udhëhoqën këto dëgjesa dhe u bënë pjesë e këtij procesi.*



## Bashkia Berat

---

Sipas grafikut të programuar zhvilloi dëgjesat publike me lagjet Nr.1.2.3 në Berat, Njësitë administrative Otlak, Sinje, Velabisht, Roshnik, me grupet e interesit dhe komunitetin, **duke tërhequr mendimet, kërkesat e sygjërimet e tyre.**

Dëgjesat publike përshtatur me udhëzimet respektive për këtë qëllim u zhvilluan në Web me listimin e kërkesave dhe mendimeve si dhe në komunikimin online sipas një grafiku të mirëpërcaktuar në kushte të plota sigurie.

Në këtë kuadër u kryen keto aktivitete:

**Aktiviteti nr. 1** - Organizimi i dëgjesave publike me komunitetin në lagjet e qytetit dhe katër Njësitë Administrative.

**Aktiviteti nr. 2** - Organizimi i dëgjesave publike me grupet e interesit.

**Aktiviteti nr. 3** - Zhvillim i dëgjesave publike me komunitetin në lagjet e qytetit , njësitë administrative dhe grupet e interesit:

**Aktiviteti nr. 4** - Miratimi i dokumentit të rishikuar të PBA 2021-2023.

1. Përgatitja e materialit të rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesem 2021 -2023, Miratimi në Këshillin Bashkiak
2. Dërgimi i materialit të këtyre aktiviteteve në Ministrinë e Financave, brenda 15 shtatorit 2020.

Propozimet e tërhequra nga komuniteti dhe grupet e interesit u administruan nga GMS dhe sipas problematikave u adresuan Ndërmarrjeve të vartësise së bashkisë, si dhe Sh.A.Ujesjëlës-Kanalizime Berat - Kuçovë, për t'i integruar në programet përkatëse buxhetore, sipas listimit të prioriteteve brënda mundësive financiare.

*Disa nga problematikat të marra nga informacionet e përgatitur nga organizimi i dëgjesave në çdo njësi administrative, lagjet e qytetit dhe grupet e interesit: ( në mënyre të detajuar janë në procesverbalet e takimeve pjesë përbërëse e dosjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, faza e rishikuar )*

**Ndërmarrja e Shërbime Publike** administroi problemet që kanë të bëjnë me:

- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore në akset dytësore të lagjeve të qytetit dhe të Njësite Administrative.
- Përmirësim të ndriçimit publik dhe mirëmbajtje cilësore të tij, dhe përpjekje për shtimin atje ku është më e domosdoshme, duke përfshirë jo vetëm lagjet e qytetit dhe qëndrat e njësite administrative por edhe fshatra.



## Bashkia Berat

---

- Përmirësim i sinjalistikës rrugore.
- Shtim të sipërfaqeve me kalldrëm kryesisht në lagjet e qytetit por dhe në qëndrën e njësive Administrative.

***Drejtoria e Arsimit e Bashkisë*** administroi problemet që kanë të bëjnë me:

- Krahas ndryshimit që solli viti 2020 theksuar kjo nga zëri i komunitetit, në dëgjesat për vitin 2021, kërkesat kanë të bëjnë me kërkesat për kënde sportive, mirëmbajtje të rrethimeve të objekteve dhe mjetet mësimore apo dhe transportin e mësuesve dhe fëmijve.
- Në kopështet dhe çerdhet në teritorin e bashkisë kërkojnë edhe për vitin 2021 të mbahet vëmendje e shtuar për situatën pandemike si dhe kujdes për ushqimin.

***Drejtoria e Bujqësisë*** administroi problemet që kanë të bëjnë me:

- Vënien në funksion të plotë të kanaleve kulluese dhe vaditëse në njësive administrative.
- Hapja e kanaleve të dyta për vaditjen e tokave.
- Zgjidhjen e problemit të rrugëve në parcelat bujqësore.
- Shtim të sipërfaqeve nën ujë dhe mirëadministrim të ujit gjatë sezonit.
- Pagesa e tarifave për mirëmbajtjen e kanaleve kulluese të jete vetëm për familjet që janë përfituese dhe jo si tarife për të gjitha familjet.

***Ndërmarrja e Gjelbërimit*** administroi problemet që kanë të bëjnë me:

- Krahas vlerësimit për atë ç'ka është realituar gjatë vitit 2020, për mirëmbajtjen e hapësirave urbane për pastrimin, kërkohet rritje e këtij shërbimi dhe shpeshimin e grafikut. Kjo për të siguruar një shërbim për gjatë gjithë kohës.
- Mirëmbajtje dhe shtimin e sipërfaqeve të gjelbëra, sidomos në hapësirat midis blloqeve të banimit,

***Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Berat - Kuçovë***, administroi problemet që kanë të bëjnë me:

- Përmirësimin e rrjetit të ujësjetës – kanalizimeve, duke reduktuar kufizimet e duke përmirësuar rrjetin e shpërndarjes.
- Përmirësim të shërbimit dhe furnizim me ujë edhe për shumë lagje të njësive administrative si në njësinë Roshnik dhe Otlak.

Programi Buxhetor Afatmesëm është hartuar në përputhje me standartet bashkëkohore duke u mbështetur edhe me trajnimet e specialisteve të financës, tatim - taksave, shërbimeve publike,



## Bashkia Berat

---

planifikimit të territorit, burimeve njerëzore, prokurimeve etj., të realizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASP), të organizuara nga Ministria e Financës.

Gjithashtu ndihmë e vyer ka qenë bashkëpunimi me **Projektin “Financat Lokale”**, i cili financohet nga Qeveria Zviceriane dhe zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, në 15 Bashki, përfshirë dhe Bashkinë Berat.

Në vitin 2019 dhe vitin 2020 Bashkia (specialistët e financës së bashkisë e të njëjve shpenzuese ) u asistua nga ekspertë të Projektit: **“Financat Lokale”**, që lehtësuan procesin e përgatitjes së PBA në funksion të kërkesave të reja ligjore. Për çdo ndërhyrje, Bashkia Berat ka zhvilluar një program buxhetor për të cilin ka identifikuar burimet që do të përdoren për të realizuar projektet.

Të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave janë marrë duke analizuar:

- ✓ Treguesit e realizuar në vitet 2017, 2018, 2019 dhe të pritshmin 2020.
- ✓ Planifikimin dhe pritshmeritë e vitit aktual 2020 si kundrejt planit fillestar dhe atij të ndryshuar, përshtatur me situatën e krijuar.
- ✓ Vlerësimin real të burimeve të të ardhurave.
- ✓ Likudjimin brënda vitit 2020 të borxhit progresiv të vitit 2019 i përbërë nga fatura të administruara nga bashkia dhe ndërmarrjet e vartësisë, pa cënuar qëndrueshmërinë financiare të Bashkisë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka konstatuar se: Bashkia Berat ka respektuar standartet e përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr 23 datë 30.07.2018, *‘Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjve të qeverisjes vëndore’*, si dhe Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.7 datë 27.02.2019 *‘Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023, ku përcaktohen se pjesë e dokumentit të hartimit të PBA janë pema e programit buxhetor, Relacioni shpjegues, Formatete outpute e Instrumentit Planifikimit Financiar dhe treguesit e performancës.*

- Projektdokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, të Bashkisë Berat është përgatitur në Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT);
- Bashkia Berat ka depozituar pranë MFE projekt dokumentit e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm, me shkresën nr. 4329 Prot. datë 15.09.2020.



## Bashkia Berat

- Raportet e projektdokumentit të PBA-së, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, janë sipas formateve të përcaktuara në udhëzimin plotësues.

Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka vlerësuar angazhimin e Bashkisë Berat në përmirësimin e procesit të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, duke e kthyer PBA-në, në një mjet të realizimit të Strategjive së Zhvillimit. Mirëpërcaktimi i Qëllimeve, Objektivave dhe Produkteve për çdo program buxhetor me tregues të matshëm si dhe planifikimi i shpenzimeve mbi bazë kosto për njësi produkti, bëjnë të mundur realizimin e Planit Strategjik të Zhvillimit.

Në dokumentin e PBA-së të Bashkisë Berat shpërndarja e burimeve është realizuar mbi bazë programi buxhetor dhe totali i tavanëve të shpenzimeve është brenda kontekstit të të ardhura vetë parashikuara. Parashikimi buxhetor është i balancuar.

*Dokumentet, mbi të cilët është mbështetur hartimi i Programi Buxhetor Afatmesëm dhe buxheti vjetor 2021 janë:*

- i. Programi qeverisës i Kryetarit të Bashkisë për periudhën 2019-2023.
- ii. Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë.
- iii. Strategjia dhe Plani i Veprimit i Turizmit.
- iv. Strategjitë sektoriale që janë të lidhura me kompetencat e pushtetit vendor.

## **2. PARASHIKIMET BUXHETORE AFATMESME 2021-2023**

### **2.1 PLANI FINANCIAR I PERIUDHËS AFATMESME 2021-2023**

Bashkia Berat, si burimi financimi të shpenzimeve vëndore për vitin 2021 dhe PBA 2021-2023 do të kete:

- i. Të ardhurave vendore të planifikuara (Plani i të ardhurave vëndore gjithësej)
- ii. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme ( e përbërë nga transfera e pakushtëzuar dhe transfera sektoriale për funksionet e deleguara)

Skema e financimit të funksioneve të reja të transferuara në njesitë e qeverisjes vendore në vitin 2016, dhe të financuara me transfertë specifike (sektoriale), në buxhetin e vitit 2021 do të vijoj të jetë transfertë e pakushtëzuar për sektorë të veçantë.



Bashkia Berat

Në dokumentin e PBA-së të Bashkisë Berat shpërndarja e burimeve është realizuar mbi bazë programi buxhetor dhe totali i tavaneve të shpenzimeve është brënda kontekstit të të ardhurave të parashikuara.

*Parashikimi buxhetor është i balancur.*

**PASQYRË PËRMBEDHËSE E BUXHETIT TË VITIT 2021 KUNDREJT  
PARASHIKIMIT TË VITIT 2020**

**(Referuar planit fillestar dhe atij të korigjuar)**

Pasqyra nr.1

Të dhënat në 000/ lekë

Nr.	Pershkrimi	Buxheti fillestar 2020	Pesha Specifike ne -%	Buxheti i rishikuar 2020	Pesha Specifike ne -%	Buxheti i planifikuar 2021	Pesha Specifike ne -%
<b>I</b>	<b>Totali i te ardhurave</b>	<b>1,075,270</b>	<b>100%</b>	<b>1,134,803</b>	<b>100%</b>	<b>1,065,417</b>	<b>100%</b>
<b>1</b>	<b>Total Transferta</b>	<b>547,061</b>	<b>51%</b>	<b>583,448</b>	<b>51%</b>	<b>565,244</b>	<b>53%</b>
a	Transferta e pakushetuar	293,099	27%	293,099	26%	298,960	28%
b	Trans. e pakushtezuar trashëguar nga viti paraardhës	0	0%	5,905	1%	0	0%
c	Transferta Specifike	253,962	24%	253,962	22%	258,148	24%
d	Transferta Specifike (mbrojtja civile)	0	0%	0	0%	8,135	1%
e	Transf. e Specifike trashëguar nga viti paraardhës	0	0%	30,482	3%	0	0%
<b>2</b>	<b>Total te ardhura te veta</b>	<b>528,209</b>	<b>49%</b>	<b>551,355</b>	<b>49%</b>	<b>500,173</b>	<b>47%</b>
a	Te ardhura te veta	528,209	49%	529,426	47%	500,173	47%
b	Te ardhura te veta trashëguar nga viti paraardhës	0	0%	21,929	2%	0	0%
<b>II</b>	<b>Totali i Shpenzimeve</b>	<b>1,075,270</b>	<b>100%</b>	<b>1,134,803</b>	<b>100%</b>	<b>1,065,417</b>	<b>100%</b>
<b>1</b>	<b>Totali shpenzime operative ( korrente)</b>	<b>901,816</b>	<b>84%</b>	<b>960,132</b>	<b>85%</b>	<b>894,774</b>	<b>84%</b>
a	Shpenzime personeli	514,286	48%	514,287	45%	521,158	49%
b	Shp.operative & mirembajtje & te tjera transferta	387,530	36%	445,845	39%	373,616	35%
<b>2</b>	<b>Shpenzime kapitale</b>	<b>173,454</b>	<b>16%</b>	<b>174,671</b>	<b>15%</b>	<b>170,643</b>	<b>16%</b>

**PLANI FINANCIAR I BASHKISË BERAT PËR PERIUdhËN  
AFATMESME 2021-2023**



Bashkia Berat


Pasqyra nr 2

Të dhënat në 000/ lekë

Nr.	Pershkrimi	Buxheti i planifikuar 2021	Buxheti i planifikuar 2022	Buxheti i planifikuar 2023
<b>I</b>	<b>Totali i te ardhurave</b>	<b>1,065,417</b>	<b>1,084,874</b>	<b>1,123,535</b>
<b>1</b>	<b>Total Transferta</b>	<b>565,244</b>	<b>569,696</b>	<b>592,901</b>
a	Transferta e pakushetzuar	298,960	303,413	326,618
b	Transferta Specifike	258,148	258,148	258,148
c	Transferta Specifike(mbrojtja civile)	8,135	8,135	8,135
<b>2</b>	<b>Total te ardhura te veta</b>	<b>500,173</b>	<b>515,178</b>	<b>530,634</b>
a	Te ardhura te veta	500,173	515,178	530,634
<b>II</b>	<b>Totali i Shpenzimeve</b>	<b>1,065,417</b>	<b>1,084,874</b>	<b>1,123,535</b>
<b>1</b>	<b>Totali shpenzime operative ( korrente)</b>	<b>894,774</b>	<b>921,617</b>	<b>949,266</b>
a	Shpenzime personeli	521,158	536,793	552,897
b	Shp.operative, & mirembajtjes& te tjera transferta	373,616	384,824	396,369
<b>2</b>	<b>Shpenzime kapitale</b>	<b>170,643</b>	<b>163,257</b>	<b>174,269</b>

Grafikisht të dhënat do të shpreheshin:

Grafiku nr.1



**TREGUES TË BUXHETETIT 2021/2020 :**





Bashkia Berat

**Indikatorë të rëndësishëm:**

<b>Nr</b>	<b>Treguesit kyc financiare</b>	<b>Buxheti 2019</b>	<b>Buxheti 2020</b>	<b>Buxheti 2021</b>
1	Shpenzime te pergjithshme / Te ardhurave te pergjithshme	100%	100%	100%
2	Taksa + tarifa vendore /Totali i te ardhurave	67%	76%	72%
3	Te ardhura te veta / Totali i te ardhurave	48%	49%	47%
4	Shpenzime kapitale / Totali i shpenzimeve	26%	16%	16%
5	Shpenzime korrente / Totali i shpenzimeve	74%	84%	84%
